



Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21 dhe 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-03 dt.21.06.2016, nenit 17, pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, dhe në bazë të kërkesës 05 nr. 350/02-52509/22 dt.09.03.2022, të aplikuesit/pronarit Betim Musliu nga Prishtina, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor, për ndërtimin e shtëpisë individuale të banimore/shtëpisë familjare me etazhitet P+2, në kuadër të parcelës ndërtimore "L-12-14", të bllokut urban "L-12", të tërësisë urbane "L", në kuadër të Planit Rregullues "Prishtina e Re - Zona Perëndim", në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës në procedurë administrative, me datë 26.04.2022 merr këtë:

V E N D I M PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. I Caktohen kushtet ndërtimore aplikuesit/pronarit Betim Musliu nga Prishtina, sipas kërkesës 05 nr. 350/02-52509/22 dt. 09.03.2022, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/ projektit ideor, për ndërtimin e shtëpisë individuale të banimore/shtëpisë familjare me etazhitet P+2, në kuadër të parcelës ndërtimore "L-12-14", të bllokut urban "L-12", të tërësisë urbane "L", në kuadër të Planit Rregullues "Prishtina e Re - Zona Perëndim", në Prishtinë, përkatësisht në parcelën kadastrale nr. 260-8 ZK Çagllavicë.

II. Lokacioni i parcelës kadastrale të lartcekur, për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor, përfshihet në kuadër të Planit Rregullues " Prishtina e Re – Zona Perëndim" i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01 nr.35-186850 dt. 02.10.2013, dhe kjo zonë është e planifikuar me destinim "Sipërfaqet e destinimit rezidencial - banimi individual".

Për kriteret urbane, parametrat dhe kushtet e ndërtimit sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor, pronarët janë informuar përmes "Shkresës" Informim nga Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim", me referencë 04-350/01-242648/21 dt. 21.05.2021. të datës 16.11.2021, dhënë nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm e Komunës së Prishtinës, përmes sistemit online.

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit - parcelës kadastrale nr. 260-8 ZK Çagllavicë, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqja, pronari dhe klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, është:
- nr. 260-8,..... me S= 500 m²,..... me pronar, Betim Musliu,..... "Arë e klasës së 4-të;
- E drejta pronësore-juridike është private, në bazë të kopjës së planit dhe çertifikatës së njësisë kadastrale;
- Bazuar në gjendjen faktike dhe incizimin gjeodezik të lokacionit, në kuadër të parcelës kadastrale të trajtuar, nuk ka ndërtim;
- Parcela kadastrale në fjalë, është e zbrazët, dhe nuk ka ndërtesa të ndërtuara në to;
- Është tokë urbane, me infrastrukturë: rrugë, ujë, kanalizim, elektrikë, etj;
- Terreni është i relativisht i rrafshët;

- Parcela kadastrale e lartcekur, ka qasja në rrugës lokale, gjendje faktike rrugë me kubëza prej betoni të lagjes rr.“Sabit Uka”, përkatësisht në rrugën e planifikuar të planit rregullues;
- Parcela kadastrale e lartcekur shtrihet në bllokun urban “L-12“;
- Në diametër prej 50 m' ka ndërtesa të ndërtuara dhe destinimi i tyre është banim individual.

IV. Kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor, për rregullimin e hapësirës dhe realizimin - ndërtimin shtëpisë individuale të banimit, në kuadër të Planit Rregullues “Prishtina e Re – Zona Perëndim” në Prishtinë, bazuar në parametrat urban të planit, janë:

- Organizimi me qasje në kuadër të parcelës kadastrale, pozicionimi, gabariti dhe etazhiteti i ndërtesës, në raport me vijën rregulluese dhe atë ndërtimore, distanca e ndërtesës nga kufiri i parcelave, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik si dhe në bazë të ‘Situacionit’ të parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese në sistemin koordinativ KOSOVAREF01”, bashkëngjitur këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore;
- Destinimi i shfrytëzimit, sipas Planit Rregullues “Prishtina e Re – Zona Perëndim”, është “Sipërfaqet e destinimit rezidencial për banimi individual”.
- Me këto kushte ndërtimore në kuadër të parcelës kadastrale nr. 260-8 ZK Çagllavicë, planifikohet ndërtimi i shtëpisë individuale banimore-shtëpisë familjare, me sipërfaqe ndërtimore, shtrirje dhe etazhitet, sipas llogarive dhe projektit konceptual, si në vijim;
 - $S = 419.00 \text{ m}^2$ / sipërfaqe e gjitha mbi tokësore.
 - Etazhitet; P+2
- Pjesa e parcelës kadastrale e trajtuar me sipërfaqe brenda vijës rregulluese – parcelës ndërtimore, për realizimin e shtëpisë individuale të banimit, është:
 - nr. 260-8 ZK Çagllavicë;..... me $S = 347 \text{ m}^2$;
 - Totale; $S = 347 \text{ m}^2$;
- Pjesa e parcelës kadastrale e trajtuar me sipërfaqe jashtë vijës rregulluese – parcelës ndërtimore, për realizimin e shtëpisë individuale të banimit, është:
 - nr. 260-8 ZK Çagllavicë;..... me $S = 41 \text{ m}^2$;
 - Totale; $S = 41 \text{ m}^2$;
- Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesës, sipas Planit Rregullues “Prishtina e Re – Zona Perëndim”, të jetë për “banim individual”, me hapësira përcjellëse, si: kthina teknike, depo, hapësira të garazheve, etj. (sipas projektit konceptual të prezantuar);
- Etazhiteti maksimal i lejuar, sipas PRRU-së, është P+2, ndërsa numri i etazheve nëntokësore nuk kufizohet, kurse etazhiteti i propozuar dhe i miratuar është P+2.
- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore – (ISHP), për vendosjen e ndërtesës në bazë – gabarit të përdheses, sipas PRR “Prishtina e Re – Zona Perëndim”, është max. 0.4 (40 %)
 - $S = 347 \text{ m}^2 \times 0.4 (40\%) = 138.80 \text{ m}^2$ / sipas PRR “Prishtina e Re – Zona Perëndim”,
 - $S = 121.73 \text{ m}^2 / 35.08 \%$ sipas projekt propozimit;
- Koeficienti i shfrytëzimit të sipërfaqja e përgjithshme ndërtimore (ISPN) sipas PRRU- së është max 450 m²
 - ISPN = max 450 m² / sipas PRR “Prishtina e Re – Zona Perëndim”;
 - ISPN = 419 m², sipas projekt propozimit;
- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore për nëntokë - (ISHN), për vendosjen e ndërtesës në bazë – gabarit të bodrumit, sipas PRR “Prishtina e Re – Zona Perëndim”, është max 0.6 (60 %)
 - $S = 347 \text{ m}^2 \times 0.6 (60\%) = 208.20 \text{ m}^2$ / sipas PRR “Prishtina e Re – Zona Perëndim”,
 - $S = 0.00 \text{ m}^2$ / nuk ka bodrum, sipas projekt propozimit;
- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore për sipërfaqet gjelbëruese – (ISHGJ), sipas pikës 2, paragrafi II. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës 01-031-185481 dt. 14.08.2015, sipërfaqja e gjelbëruar e parcelës, e përcaktuar në bazë të Indeksit të Sipërfaqes së

Gjelbëruar, duhet të jetë së paku 40%, përjashtimisht kur ndërtohet kulmi me gjelbërim, kjo sipërfaqe mund të jetë së paku 30%.

- $S = 347 \text{ m}^2 \times 0.40 \text{ (40\%)} = 138.80 \text{ m}^2$ / sipas Vendimit të Kryetarit;
- $S = 141.15 \text{ m}^2 / 40.67 \%$, sipas projekt propozimit;
- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt.14.08.2016 dhe protokolluar me numrin 01 nr. 031-185481, për shkaqe të shfrytëzimit eficient të energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;
- Bazuar në kriteret e PRrU-së " Prishtina e Re – Zona Perëndimore", distanca më e vogël nga parcela fqinje është 3.0 m`. Në rastin që kjo distancë tejkalohet, duhet patjetër të sigurohet pëlqimi i noterizuar i fqit.
- Terasat, shkallët e jashtme, ballkonet, konzollat, etj, nuk mund të ndërtohen në distancë më të vogël se 3.0 m` nga parcela fqinje, apo jashtë vijës ndërtimore;
- Rrethojt kryesisht duhet të jenë transparente apo rrethoje të gjelberta. Baza e rrethojes nuk duhet të jetë më e naltë se 50 cm, mund të jetë nga betoni, tulla apo guri. Pjesa e rrethojes mbi bazë duhet të ndërtohet me materiale të lehta sikur druri, metali apo diçka e ngjashme. Rrethoja përkaj rrugës ka lartësi prej max 1.5m ndërsa në kufi me parcelën fqinje mund të jetë max 2.0 m.
- Qasja në objekt duhet të jetë nga rruga lokale ekzistuese, dhe rruga e planifikuar sipas Planit Rregullues;
- Për shtëpi individuale banimi duhet të sigurohet 1 vendpакrim, për njësi;
- Në kuadër të parcelës të parashihet hapësira për vendosjen e mbeturinave;
- Arkitektura/dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të eficiencës së energjisë, dhe ti përshtatet ambientit për rreth;
- Zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet ashtu që të jetë në harmoni me projektin arkitektonik dhe uji i strehëve duhet të derdhet brenda parcelës ndërtimore.
- Të bëhet aplikimi i të gjithave kushteve tjera urbane dhe arkitektonike të përcaktuara në kriteret dhe parametrat urban të Planit Rregullativ " Prishtina e Re – Zona Perëndimore, si dhe me normat dhe standardet tjera të planifikimit.

V. Kyçja në infrastrukturë - marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina", bëhet me aplikim nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin-adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Vendimin për caktimin e kushteve ndërtimore;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrike dhe ujë).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos"-Ngrohitorja e Qytetit sh.a. dhe PTK.

VI. Dokumentacioni ndërtimor - projekti ideor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV, projekt propozimin e prezantuar, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, të dorëzohet në tre (3) kopje të shtypura, dhe një (1) digjitale dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Planin e situacionit të gjerë, në diametër prej 50m`, me ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:500 apo 1:1000, punuar në bazë të incizimit gjeodezik të parcelës ndërtimore me

- rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesës së projektuar dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Planin e situacionit të parcelës, në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë dhe me pozicionim të ndërtesës në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të platove, trotuareve, rrugëve dhe hyrjeve në përdheshë, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:100, për ndërtesën e projektuar, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdheshë dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Dukja e jashtme e ndërtimit, tridimensionale - perspektivë;
- Planin me vendin e qasjes në ujësjellës dhe kanalizim, në përpjesë 1:100;
- Planin me vendin e qasjes në furnizim me energji elektrike në përpjesë 1:100;
- Përshkrimin teknik të punëve ndërtimore;
- Paramasën dhe parallogarinë e punëve ndërtimore dhe ndërtimore zejtare;
- Detajet karakteristike dhe të nevojshme, në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20;
- Situacionin me përshkrimin teknik të "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim";
- Masat propozuese për fizikën ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma, me analiza dhe masa konkrete;
- Deklaratën e projektuesit për fazat e nevojshme.

VII. Ndarja/parcelimi, i parcelës kadastral nr. 260-8 ZK Çagllavicë, do të realizohet sipas parcelës ndërtimore me koordinatat e vijës rregulluese, ndërtimore si dhe vijave të riparcelimit dhe propozim për ndarje të parapara sipas Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim", të punuar nga gjeodeti i licencuar Festim Islami, me nr. të licensës 12 dhe nga kjo drejtori, si dhe bazuar në Planin e situacionit – "zgjidhjes urbane".

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për ndarjen e parcelës kadastrale të lartcekur, sipas Planit të situacionit-"zgjidhja urbane" dhe manualit të ndarjes. Procedura e ndarjes/parcelimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e përshkruar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve;

Procedura e ndarjes të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas vendimit të kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarit, duke u bazuar edhe në, Plani i situacionit - "zgjidhja urbane" dhe "Situacioni i parcelës me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01", punuar nga kjo drejtori dhe manualit të ndarjes, punuar nga gjeometri i licencuar, e të cilat janë pjesë përbërëse të këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

VIII. Pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore - meqenëse parcela kadastrale nr. 260-8 Zona Kadastrale Çagllavicë, në bazë të çertifikatës së njësisë kadastrale, është evidentuar me lloj të shfrytëzimit të parcelës - tokë bujqësore, me kulturë 'arë e klasës 4', kërkohet që paraprakisht të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, konform nenit 11, 13 dhe 14 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8, 9 dhe 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë.

Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do të ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet, sipas Planit të situacionit – "zgjidhja urbane", dhe e njëjta do të përfshijë sipërfaqen e parcelës ndërtimore, prej S=347 m². Kjo sipërfaqe do të regjistrohet si tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, kjo Drejtori jep PËLQIM për ndërrimin e destinimit të tokës, vetëm për parcelën ndërtimore që do të ndërtohet.

Ky kompensim - pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore.

IX. Marrëveshja për infrastrukturë – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të “Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01 nr. 434/01–0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të aplikuesit.

X. Pagesa e taksës administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të realizohet sipas “Rregullores mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01Nr.434/01 – 0094474/17 dt.24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor / projektin ideor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

XI. Vlefshmëria e vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore do të jetë një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

A r s y e t i m

Aplikuesit/pronarit Betim Musliu nga Prishtina me kërkesën 05 nr.350/02-52509/22 dt.09.03.2022, kanë kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor, për ndërtimin e shtëpisë individuale të banimore/shtëpisë familjare me etazhitet P+2, në lokacionin e përshkruar në paragrafin I. të dispozitivit të këtij Vendimi.

Me kërkesën për kushte ndërtimore 05 Nr. 350/02-52509/22 dt. 09.03.2022 dhe gjatë fazës së zhvillimit të procedurës, është prezantuar dhe trajtuar dokumentacioni dhe provat, si në vijim:

- Dëshminë mbi pronësinë, kopjen e planit për parcelat kadastrale nr. 260-8, të evidentuar në certifikatën e njësisë kadastrale P-71914075-00260-8 ZK Çagllavicë në emër të Betim Musliu të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës (Vërtetim kopje nga origjinali, i noterizuar te noter Arbena Shehu, Rr.Garibaldi, Hy.II/1, nr.5, në Prishtinë, LRP.nr. 11338/2021 dt. 09.11.2021).
- Vërtetimin mbi obligimet tatimore, në emër të Betim (Rifat) Musliu, Nr.52220/22 dt. 09.03.2022, të lëshuar nga Drejtoria e Financave;
- Kopjen të dokumentit të identifikimit të pronarit Betim Musliu;
- Shkresën “Informimin nga Plani Rregullues “Prishtina e Re – Zona Perëndim” me referencë 04 Nr.350/01-242648/21 dt. 21.05.2021, të datës 16.11.2021, të lëshuar përmes sistemit online nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm e Komunës së Prishtinës;
- Aktin noterial “Pëlqim” i pronarit; z.Mendim Daka nga Prizreni dhënë pronari z.Betim Musliu, jep pëlqimin dhe pajtohem që fqiu im të afrohet deri në 1 m (një meter) afër kufirit të parcelës

time P-71914075-00259-9 ZK Çagllavicë, i përpiluar dhe noterizuar te notere Arbena Shehu, Rr.Garibaldi, Hy.II/1, nr.5, në Prishtinë, LRP.nr. 11542/2021 dt. 15.11.2021.

- Aktin noterial "Pëlqim" i pronarit; z.Haxhi Berisha nga fshati Qeskovë, Komuna e Klinës dhënë pronari z.Betim Musliu, jep pëlqimin dhe pajtohem që fqiu im të afrohet deri në 1 m (një meter) afër kufirit të parcelës time P-71914075-00259-8 ZK Çagllavicë, i përpiluar dhe noterizuar te notere Arbena Shehu, Rr.Garibaldi, Hy.II/1, nr.5, në Prishtinë, LRP.nr. 11797/2021 dt. 19.11.2021.
- Inçizimin gjeodezik për parcelat kadastrale nr. 260-8ZK Çagllavicë, i punuar nga gjeodeti i licencuar Festim Islami, me nr. të licensës 12;
- Manuali gjeodezik për parcelën kadastrale nr. 260-8ZK Çagllavicë, me ndarje, i punuar nga gjeodeti i licencuar Festim Islami, me nr. të licensës 12;
- Një kopje të dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor të shtëpisë individuale të banimore-shtëpisë familjare në kopje të fortë/fizike dhe kopje digjitale në CD, të hartuar nga kompania projektuese "Modul Projekt" Sh.p.k nga Prishtina, me çertifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 811048447;

Drejtorja e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës 05 Nr. 350/02-52509/22 dt. 09.03.2022, dokumentacionit të prezantuar me prova të bashkangjitura, konsultimit të dokumenteve të planifikimit për hapësirën ku gjendet lokacioni - Planit Rregullues "Prishtina e Re - Zona Perëndim" rregullativën ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe i procedurës së përgjithshme administrative, projektit konceptual, ka konstatuar se parcelës kadastrale nr. 260-8 ZK Çagllavicë, shtrihet në kuadër të parcelës ndërtimore "L-12-14", të bllokut urban "L-12", të tërësisë urbane "L", në kuadër të Planit Rregullues "Prishtina e Re - Zona Perëndim", i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01 nr.35-186850 dt. 02.10.2013, dhe kjo zonë është e planifikuar me destinim "Sipërfaqet e destinimit rezidencial për banimi individual".

Duke u bazuar në nenin 18 të Ligji Nr.04/L-110 për Ndërtim, pikën 1.2 dhe 1.2.2 të nenit 13 të Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, kjo drejtori me datë 06.04.2022 ka vendosur njoftimin publik në hapësira të dukshme dhe frekuentuese të lokacionit dhe rrethinës në diametër prej 50 m, për të njoftuar publikun me synimin e pronarëve dhe investitorit, për ndërtim, dhe i njëjti është lënë në dispozicion të tyre për 5 (pesë) ditë, për t'ju mundësuar të interesuarve paraqitjen e vërejtjeve dhe komenteve. Ky njoftim publik ka vazhduar të qëndrojë deri me datën 10.04.2022, dhe gjatë kësaj periudhe kohore, në postën elektronike zyrtare nuk ka arritur asnjë ankesë, kërkesë, vërejtje apo sugjerim nga qytetarët e asaj zone.

Me dokumentacionin ndërtimor-projektin ideor është miratuar koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore për hapësira gjelbëruese (ISGJ) (me gjelbërim të lartë dhe të ultë) dhe absorbues min. 40%, konform paragrafit II. pika 1. të Vendimit 01 Nr. 031-185481 dt. 14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dhe organizuar për sport dhe rekreacion, sipas planit të situacionit dhe normat teknike të planifikimit hapësinorë.

Pas shqyrtimit dhe analizimit të saj, bazuar në analizën urb-arkitektonike - të Planit Rregullues "Prishtina e Re - Zona Perëndim", dhe projektit konceptual - "zgjidhja urbane", është konstatuar se ndërtesat e planifikuara të pozicionohet në distancë 1.00 m, nga kufiri i parcelës kadastrale fqinje nr. 259-9 ZK Çagllavicë, dhe në distancë 1.0 m, nga kufiri i parcelës kadastrale nr. 259-8 ZK Çagllavicë, pas sigurimit dhe prezantimit të aktit noterial "Pëlqim" të pronarit z.Mendim Daka nga Prizren, pronar i parcelës kadastrale nr. 259-9 ZK Çagllavicë, dhënë z.Betim Musliu nga Prishtina, për lejimin e ndërtimit të shtëpisë deri në 1 (një) metër afër kufirit të parcelës, e noterizuar te noterja Ma.Sc. Arbena Shehu, në Prishtinë, LRP.nr. 11542/2021 dt. 15.11.2021, dhe aktit noterial "Pëlqim", të pronarit Haxhi Berisha nga Klina, pronar të parcelës kadastrale nr. 259-8 ZK Çagllavicë, dhënë z.Betim Musliu nga Prishtina, për lejimin e ndërtimit të shtëpisë në kufirin e parcelës së tij deri në 1 (një) metër, e noterizuar te notere Ma.Sc. Arbena Shehu, në Prishtinë, LRP.nr. 11797/2021 dt. 19.11.2021;



Në analizën e situacionit nga aspekti i komunikacionit dhe prezantuar në shkresën e zyrtarit – ekspertit për komunikacion, janë përcaktuar masat që duhet të ndërmerren, për kyçje të parcelës në rrugën ekzistuese të lagjes, dhe është konstatuar, si në vijim:

“ Pas shiqimit të propozimit të situacionit të zgjidhjes urbane të Betim Musliu, në lagjen Prishtina e re, Zona Perëndim, Zk. Çagllavicë, Prishtinë, lidhur me kërkesën për kushte ndërtimore të lëndës 05-351/02-52509/22 dt.09.03.2022, kyçja për automjete në rrugën ekzistuese e cila është e paraparë edhe me planin rregullues Prishtina e re, zona perëndim, për ndërtesën banimore - shtëpi individuale me etazhitet P+2, të paraparë me këtë zgjidhje urbane, mund të pranohet si e tillë marrë parasysh edhe lokacionin e zgjidhjes urbane ne raport me rrugën e planifikuar. Kyçja duhet ti përshtatet teknikisht rrugës së planifikuar dhe të aplikohen kushtet e shikueshmërisë horizontale dhe vertikale në lokacionin e kyçjes dhe në kohën kur realizohet ajo ”.

Bazuar në konstatimet e më sipërme dhe dokumentacionin e shqyrtuar, rregullativës ligjore në fuqi, konkretisht nenin 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenin 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 31.07.2013, nenin 13 të Udhëzimit Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrërimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve”, Drejtoria e Urbanizmit ka konstatuar se kërkuuesi ka prezantuar të gjitha dokumentacionin e nevojshëm, se plani i situacionit – “zgjidhja urbane”, është në harmoni me destinimin dhe kriteret tjera të planit rregullues urban për atë hapësirë, si dhe në harmoni me rrethinën, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore.

Nga sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

Shtojcë: Plani i Situacionit – zgjidhja urbane dhe “Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga Plani Rregullues në sistemin koordinativ Kosovaref01” të punuar nga kjo Drejtoria.

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtoria, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

Ky vendim u printua në 4 (katër) kopje identike dhe i dërgohet: Aplikuesit/Investitorit, në dosje të lëndës 05 Nr.350/02-52509/22 dt. 09.03.2022, kësaj drejtorie dhe Qendrës për shërbim me qytetarë.

Kopja elektronike i dërgohet: Drejtorisë së Pronës, Drejtorisë së Kadastrit dhe Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS

05 NR. 350/02-52509/22 Dt. 26.04.2022

Zyrtari,
Ardian Zymeri

u.d Udhëheqëse e Sektorit,
Mimoza Berisha - Prestreshi





Republika e Kosovës
 Qeveria - Vlada-Government
 Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit/Ministry of Infrastructure and Environment
 AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/KATASTRALSKA AGENCIJA KOSOVA/KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: Prishtine


Zona kadastrale / Katastarska zona: Çagllavice

Lloji i ngjësise kadastrale / Vrsta katastarske jedinice : Parcel

Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: 250

Propozim për ndarje sipas Planit Rregullues Urban - Prishtina e Re - Zona Perendimore

Nr	Y	X	H
1	7511484.13	4720865.04	0.00
2	7511486.69	4720879.23	0.00
3	7511467.91	4720882.13	0.00
4	7511466.41	4720873.86	0.00
5	7511465.35	4720867.99	0.00
6	7511463.75	4720855.95	0.00
7	7511482.58	4720853.44	0.00
8	7511464.51	4720861.65	0.00
9	7511481.40	4720859.69	0.00
10	7511484.42	4720879.58	0.00



Rilevori / Snihtor: Festim Islami

(emri dhe mbiemri i gjedevit/kompanisë/ emri i prezimit gjedevit/kompanisë)

Aprovori / Usvojio:

(emri dhe mbiemri i personit zyrtar/ emri i prezimit shuzbenegjic)

Nenshkrimi / Poypis:

Data e aprovimit / Datum usvajanja: _____


Nr. i licencës / Br. licence: 12

[Signature]

Nenshkrimi / Poypis: _____

Data e rilevimit / Datum snimanja: 06.05.2022





PARCELA 0260-8


- KUFIRI PARCELËS S=346 m²
- GABARITI I SHITËRISË S=121.73 m²
- KUBËZA BETONI S=50.98 m²
- GJELBRIM S=141.15 m²
- HAPËSIRË TROTUAR 1.60m S=32.14 m²

Klienti:

BETIM MUSLIU

Projekuesi:

"MODUL PROJEKT" shpk



Emri i Projektit:

Shtëpi individuale P+2

Vendi:

ZK Çagllavicë - Prishtinë

Parcela:

Sipërfaqja: Sipërfaqja Etazhës

260-8 S=500 m²

ARKITEKTURA

Faza e Projektit:

Projekt zbatues

Emri i Vizalimit:

SITUACIONI

Projektes:

Msc.ark. Përparim Çajaj

Projektes:

Msc.ark. Përparim Çajaj

Msc.ark. Përparim Çajaj

Msc.ark. Përparim Çajaj

Msc.ark. Përparim Çajaj



Dala:

MARS 2022

Përplasa:

1:100

Faqja:

.17

V.V.

0260-9

Ø-642.42

0259-8

0259-9

346m²

154m²